

**Sekretariati i Këshillit të Investimeve**

# Komente nga Anëtarë të mëparshëm të KI nga Biznesi, 2016-2017

*Arritja e qëllimeve përmes përfshirjes proaktive të biznesit*

**25 prill 2018**

## **Përmbajtja**

Anëtarë të Biznesit në Këshillin e Investimeve, 2016-2017.....	3
Konteksti .....	5
I. Mbi Eksperiencën si Anëtar i KI .....	6
II. Formati dhe Organizimi i KI.....	7
III. Metoda e Punës së KI .....	7
IV. Impakti i KI.....	8
V. Transparenca .....	8
VI. Angazhimi i anëtarëve .....	9
VII. Qëndrueshmëria .....	9
VIII. Mbi Klimën e Investimeve .....	10
IX. Investment Council Friends .....	10

## Anëtarë të Biznesit në Këshillin e Investimeve, 2016-2017



*Z. Luan Leka*  
*Drejtor Ekzekutiv, EHW GmbH*



*Z. Arben Shkodra*  
*Sekretar i Përgjithshëm,*  
*Shoqata Shqiptare e Prodhuesve*



*Z. Shkëlqim Bozgo*  
*Ish Drejtor i Përgjithshëm, TAP*



*Znj. Edlira Muka*  
*CEO, Balfin Group*



*Z. Mark Crawford*  
*President, Dhoma Amerikane e Tregtisë*



*Mr Luan Bregasi*  
*President, BiznesAlbania*

## Konteksti

Gjatë tre viteve të tij të para (2015-2017), Këshilli i Investimeve (KI), ka luajtur një rol të rëndësishëm në debatin kombëtar mbi çështje të mprehta të klimës së investimeve në vend. Fokusi kryesor i punës së tij lidhet me mjedisin institucional, rregullator dhe politik në të cilën kompanitë investojnë, krijojnë vende pune apo zgjerohen, por edhe me ndërveprimin me institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë privatë që influencojnë performancën ekonomike të vendit.

Objekti kryesor i punës së KI konsiston në:

1. Promovimin dhe strukturimin e debatit mbi klimën e investimeve bazuar në konsultimet direkte me biznesin.
2. Përgatitjen e rekomandimeve konkrete dhe konstruktive për përmirësimin e klimës së biznesit dhe paraqitjen e tyre institucioneve përkatëse.
3. Promovimin e qeverisjes së mirë me palët publike dhe private.

Në total, gjatë periudhës 15 prill 2015 – 15 prill 2018, Këshilli i Investimeve ka patur 18 anëtarë përfaqësues të komunitetit të biznesit (9 shoqata dhe 9 biznese), të cilët kanë kontribuar në mënyrë aktive në prioritizimin e problematikave kryesore për investime në vend dhe në dhënien e rekomandimeve për adresimin e tyre.

Në kuadër të standardit dhe metodologjisë së punës së KI, në periudhën mars - prill 2018, Sekretariati organizoi takime me secilin prej anëtarëve të KI, përfaqësues të sektorit privat, mandati i të cilëve përfundoi në fund të vitit 2017 – në raundin e dytë të rotacionit të anëtarëve të biznesit<sup>1</sup>.

Qëllimi i takimeve ishte marrja e mendimeve mbi eksperiencën e tyre si anëtarë në KI, sugjerime për përmirësime në lidhje me KI dhe punën e Sekretariatit, sikurse edhe në lidhje me klimën e investimeve në vend.

---

<sup>1</sup> Shënim: Ky raport nuk përfshin pikëpamjet e z. Luan Bregasi.

Eksperienca dhe sugjerimet e perfaqësuesve të biznesit janë sjellë në mënyrë të konsoliduar më poshtë sipas shtyllave kryesore.

## I. Mbi Eksperiençën si Anëtar i KI

*Si ka qenë eksperienca juaj si anëtar i Këshillit të Investimeve?*

- ✚ Eksperienca ka qenë pozitive dhe KI ka shërbyer si një dritare për të ndarë eksperienca dhe kontribute përtej interesit të ngushtë të kompanisë që përfaqësoj.
- ✚ Ka një standard të mirë organizimi dhe diskutimi në interesin më të mirë të biznesit.
- ✚ Konsultimi paraprak i materialeve dhe prezantimeve të mbledhjes japin mundësi për diskutime më të plota nga anëtarët e KI.

*Cilat do t'i konsideroni si pikat e forta të KI?*

- ✚ Platformë e konsoliduar tanimë, funksionale dhe me axhendë serioze.
- ✚ Analizat janë të thelluara, të elaboruara, të mbështetura në vlerësime të sakta.
- ✚ Mbështetja e BERZH dhe diversiteti i përbërjes së KI mbështetur në trekëndëshin Qeveri-Biznes-Donatorë.
- ✚ KI është platformë e orientuar drejt rezultateve. Çështjet që janë diskutuar në KI ose kanë marrë zgjidhje konkrete ose janë bërë objekt debati midis profesionistëve apo medias.

*Cilat do të vlerësonit si mundësi për përmirësimin e mëtejshëm të punës së KI?*

- ✚ Sekretariati i KI duhet të promovojë sa më shumë rezultatet e punës së KI nëpërmjet publikimit të indikatorëve të qartë mbi zbatimin apo ndjekjen e rekomandimeve.

- ✚ Problemet e klimës së biznesit janë më të shumta se axhenda e KI. Për këtë arsye mbledhjet duhet të jenë më të gjata.
- ✚ Vetë anëtarët përfaqësues të biznesit duhet të jenë më aktivë në diskutimin e problematikave përkatëse në interes të një grupi më të gjerë interesi.
- ✚ Puna analitike e Sekretariatit dhe KI duhet të materializohet në aksione konkrete nga institucionet vendimmarrëse.

## II. Formati dhe Organizimi i KI

*Si ju duket formati dhe organizimi i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve? A e vlerësoni KI si formatin e duhur të fokusuar në çështjet e klimës së investimeve, duke patur parasysh trekëndëshin e anëtarëve: institucione kombëtare, biznese dhe shoqata biznesi, dhe donatorë dhe institucione ndërkombëtare?*

- ✚ Formati më i mirë dhe më i strukturuar. Modeli më i mirë dhe efikas për të shtyrë gjërat përpara.
- ✚ Përbërja e anëtarësisë (Qeveri-Biznes-Donatorë) është e mirë. Rotacioni i anëtarëve është i mirë sepse krijon freski me anëtarë të rinj të cilët përfaqësojnë grupe të gjera interesi. Propozohet që Zv/Ministri i Jashtëm, të jetë anëtar i përhershëm i KI në kuadër të diplomacisë ekonomike.
- ✚ Frekuenca e rotacionit të anëtarëve të biznesit çdo vit mund të jetë objekt rishikimi. Afati 1 vit i mandatit të anëtarëve nga biznesi disi i shkurtër duke marrë në konsideratë dhe kohën e nevojshme të ambjentimit.
- ✚ Duhet një prezantim paraprak me anëtarët e rinj për të kuptuar rolin dhe angazhimin e tyre në kuadër të KI për të qenë më të përgjegjshëm dhe më aktiv.

## III. Metoda e Punës së KI

*Cili është vlerësimi juaj mbi mënyrën/metodologjinë e trajtimit të tematikave në Këshillin e Investimeve.*

- ✚ Metodologjia e zgjedhur për trajtimin e problematikave nëpërmjet votimit nga vetë anëtarët është shumë e mirë, sepse sjell direkt zërin e biznesit.
- ✚ Filtrimi i problematikave dhe rekomandimeve nëpërmjet Notave Teknike ngre standardin e diskutimeve në KI.
- ✚ KI nevojitet të fokusohet më shumë në çështje dhe problematika specifike pasi kapacitetet e Sekretariatit të KI janë të kufizuara;
- ✚ Qeveria të përdorë axhendën e KI për të diskutuar prioritetet, iniciativat dhe reformat e saj.
- ✚ Bizneset nuk mund të thonë hapur të gjitha gjërat dhe problematikat për shkak të vetë terrenit të diskutimit në Shqipëri dhe shpesh përdorin aleancat me shoqatat e biznesit. Evidentimi i problematikave dhe aktorëve kryesorë që ka bërë Sekretariati ka qenë i duhuri.

## IV. Impakti i KI

*A mendoni se puna e KI ka patur impakt në klimën e biznesit në vend dhe nëse ka bërë diferencën nga formate të ngjashme të dialogut publik - privat?*

- ✚ Ndonëse, shumë rekomandime të KI janë marrë në konsideratë nga Qeveria, mbetet i nevojshëm monitorimi i shpeshtë i rezultateve të tyre në rang kombëtar, për të matur impaktin e KI.
- ✚ Është e vështirë të matet impakti. Kriteri kryesor duhet të jetë numri i rekomandimeve të zbatuara nga Qeveria.
- ✚ Rekomandimet e miratuara në KI janë të vlefshme. I mbetet Qeverisë vullneti për zbatimin e tyre në praktikë.
- ✚ Impakti i punës së KI varet edhe nga axhenda e institucioneve vendimmarrëse.

## V. Transparenca

*Në lidhje me transparencën dhe vizibilitetin e punës së Këshillit të Investimeve a mendoni se është i njohur sa duhet tek komuniteti i biznesit?*



- ✚ Platforma e KI të përdoret më shumë nga Qeveria në lançimin e iniciativave të saj, veçanërisht atyre ligjore, të cilat kanë impakt për biznesin;
- ✚ Ka ende hapësira për sipërmarrjen që të informohet lidhur me punën dhe rolin e Këshillit.
- ✚ Vizibiliteti i KI është në masën e duhur. Nuk ka nevojë për media. Shumë PR mund të krijojë hapësirë për keqinterpretime dhe mund të dëmtojë imazhin e KI.
- ✚ Materialet janë transparente dhe të paanshme – të gjitha të publikuara në faqen e KI.

## VI. Angazhimi i anëtarëve

*Si e vlerësoni angazhimin e anëtarëve të KI në diskutime?*

- ✚ Biznesi ka qenë aktiv, por nuk dëgjohej sa duhet.
- ✚ Qeveria duhet të jetë sa më proaktive dhe të dëgjojë diskutimet, përndryshe kthehet në monolog.
- ✚ Bizneset kanë evoluar dhe janë më të përgatitur për të përballur problematikat e klimës së investimeve dhe të gatshëm për investime në fusha të tjera.
- ✚ Biznesi vetë duhet të jetë më aktiv dhe vizionar. Është shumë e vështirë të gjejsh analiza të hartuara apo parashtruara nga biznesi mbi modelin ekonomik. Bizneset priren të ngrenë në nivel diskutimi çështje individuale dhe jo çështje të politikave ekonomike me interes për të gjithë shoqërinë.

## VII. Qëndrueshmëria

*A e shikoni Këshillin e Investimeve si një platformë afatgjatë dhe me interes për biznesin?*

- ✚ Platformë e nevojshme për vendin në terma afat-gjatë;
- ✚ Ndonëse një organ konsultativ, KI ka ndihmuar në strukturimin e debatit, opinionet dhe analizat;
- ✚ Iniciativa duhet të jetë afatgjatë dhe qëndrueshme. Mbështetja nga BERZH rrit profilin dhe garanton qëndrueshmëri.

## VIII. Mbi Klimën e Investimeve

*Cilat konsideroni si problemet kryesore të klimës së investimeve në vend?*

- ✚ Infrastruktura (porte, aeroporte, rrugë);
- ✚ Niveli i lartë i barrës fiskale dhe vonesat në rimbursimin e TVSH-së;
- ✚ Niveli mediokër i administratës;
- ✚ Mungon një plan për nxitjen e konkurrueshmërisë në tregjet rajonale të sipërmarrjes shqiptare;
- ✚ Burime të kufizuara njerëzore dhe cilësi e kufizuar e tyre veçanërisht jashtë Tiranës;
- ✚ Kuadri i paqëndrueshëm në aspektin e konfliktit politik;
- ✚ Furnizimi me energji dhe investimet private në sektorin e energjisë;
- ✚ Produkte investimesh për investitorët e mundshëm;
- ✚ Çështjet që lidhen me pronën. Mungesa e regjistrimit të dixhitalizuar të pronave.

## IX. Investment Council Friends

*Si e vlerësoni iniciativën e Sekretariatit për krijimin e një Forumi me të gjithë anëtarët ndër vite në KI nga komuniteti i biznesit?*

- ✚ Iniciativë pozitive. Forumi mund të shërbejë si qendër lobimi e konsoliduar për 3-4 çështjet më kryesore që shqetësojnë të gjithë komunitetin e biznesit në vend.
- ✚ Iniciativa e propozuar mund të materializohet në formën e një takimi në vit, ku të parashtrihen për diskutim ato tema të cilat nuk kanë qenë më parë pjesë e axhendës së KI.
- ✚ Krijon një imazh pozitiv, rrit profilin e biznesit dhe shërben si një mekanizëm advokimi për rekomandimet e miratura nga KI dhe krijon sinergji më të madhe për presion pozitiv ndaj institucioneve.